



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 5 tetor 2012

Nr. i lëndës 2011-20

X. dhe 115 ankues të tjera

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 5 tetor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Duke shqyrtuar ankesën e lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 9 qershor 2011.
2. Paneli ka pranuar dëshirën e ankuesve që mos t'iu zbulohen emrat.
3. Pasi që z. John Ryan ishte këshilltar i lartë ligjor në Panelin Këshillëdhënës të të Drejtave të Njeriut (PKDNj) për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK-u) atëherë kur kjo lëndë e ankuesve ishte shqyrtuar nga ai Panel, ai tanë nuk merr pjesë në procedurat që zhvillohen nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.

II. FAKTET

4. Faktet e lëndës, ashtu siç janë parashtruar nga parashtruesi i ankesës, sipas dokumenteve që iu janë paraqitur Panelit, dhe sipas informatave të tjera përkatëse nga burime zyrtare, mund të përmblidhen si në vijim.

Të dhëna paraprake rreth kampeve të PZhBV

5. Gjatë konfliktit të vitit 1999, shumë romë nga mahalla e romëve (gjithashu e njojur si Fabrika apo Mahalla në Mitrovicë) dhe pjesë të tjera të Kosovës kanë ikur drejtë pjesës veriore të Kosovës si pasojë e dhunës ndëretnike dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre.
6. Rreth 600 romë, ashkali dhe engjiptas kosovarë të zhvendosur brenda vendit ishin vendosur në kampe për personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV).
7. Kampet Cesminlukë (në komunën e Mitrovicës) dhe Zhikoc (në komunën e Zveçanit) ishin themeluar nga zyra e komisionarit të lartë për refugjatë (UNHCR) në vitin 1999.
8. Kampi i tretë ishte ndërtuar në Leposaviq në vitin 1999, diku 45 kilometra larg Trepçës.
9. Në vitin 2001, kampi i katërt, kampi Kablare, ishte vendosur afër Cesminlukës. Dy kampet e para dhe kampi i katërt ishin vendosur 3 kilometra brenda shkridores së Trepçës dhe 300 metra brenda dy deponive të minierës.
10. Kampi i pestë, kampi Osterodë, ishte një kamp ushtarak i ish Jugosllavisë i shfrytëzuar nga KFOR-i francez nga viti 1999-2005, ku pastaj ajo ishte shndërruar në një kamp për personat e zhvendosur brenda vendit ("PZhBV"). Kampi Osterodë kishte hyrë në funksion në vitin 2006. Ky kamp gjendet brenda qytetit të Mitrovicës, ku jo më larg se 20 metra prej portës së kampit gjenden ndërtesa banimi.
11. Edhe pse kampet ishin ndërtuar si masë e përkohshme, për një kohë të gjatë përpjekjet për të gjetur banim alternativ ishin të pasuksesshme, pasi nuk mund të identifikohej ndonjë parcelë e përshtatshme nga autoritetet vendore për strehim të ri.
12. Kushtet e jetesës në kampet e PZhBV ishin dhe vazhdojnë të jenë tejet të këqija. Përpos kësaj, ishte konstatuar që prej vitit 2000 nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u), KFOR-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) se si pasojë e punimeve të mëhershme xehetare, toka në atë zonë ishte jashtëzakonisht e ndotur, posaçërisht nga plumbi. Shumica e personave që jetojnë në ato kampe kanë pasur përqindje të plumbit në gjak që i tejkalonte nivelet e pranuara mjekësore.

13. Romët që jetojnë në këto kampe dyshohet se ishin njoftuar rreth reziqeve që i kanosej shëndetit të tyre nga helmimi me plumb jo më herët se në vitin 2005.
14. Kampi i Zhikocit ishte në funksion nga viti 1999 deri më 2006; kampi i Cesminlukës nga viti 1999 deri më 2010; ndërsa kampi i Kablarës nga viti 2001 deri më 2006.
15. Kampi i Osterodës ka qenë në funksion që nga viti 2006. Kampi i Leposaviqit ka mbetur në funksion që nga viti 1999.
16. Në vitin 2006, disa prej banorëve të kampit të Cesminlukës ishin zhvendosur në Osterodë. Disa banorë nuk kishin pranuar që të largoheshin për në Osterodë, pasi ata nuk mendonin që ai ishte zgjedhje më i mirë sesa vendbanimi i tanishëm i tyre.
17. Nga viti 2001 deri më 2008 UNMIK-u ishte përgjegjës për këto kampe. Në maj të vitit 2008, UNMIK-u për kampet e mbeturia ia kishte dorëzuar përgjegjësinë qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
18. Në janar të vitit 2009 ishte bërë dorëzimi i menaxhimit të kampeve të Cesminlukës dhe Osterodës nga Kisha Norvegjeze për Ndihma (Norwegian Church Aid) tek një OJQ vendore, pra tek Agjencia Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KAAD), e financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Në prill 2009, zyra e kryeministrit në një deklaratë publike ka pohuar se do të merrej me problemin e ndotjes nga plumbi.
19. Përfundimisht, autoritetet vendore kosovare caktuan një parcelë të përshtatshme për ndërtimin e strehimoreve për familjet që jetonin në ato kampe. Projekti për risistemim, në mesin e të tjerëve, i financuar edhe nga Bashkimi Evropian dhe USAD-i, lejuan që kampi i Cesminlukës të evakuohet dhe shkatërrohet në tetor të vitit 2010.
20. Pas xhiros së fundit të risistemimit në tetor të vitit 2011, kampi i Osterodës ende strehon rreth 10-20 familje.¹ Paneli nuk ka njohuri se sa familje banojnë në kampin e Leposaviqit.

Informata paraprake rreth ankuesve

21. Ankuesit janë 116 familje rome dhe anëtarë të familjeve rome. Shumë prej ankuesve dyshohet se vuajnë nga sëmundje të shkaktuara nga plumbi.
22. Në kohën e paraqitjes së ankesës pranë Panelit në qershor të vitit 2011, shumë ankues kanë paraqitur se adresat e tyre janë qoftë kampet e Cesminlukës, Osterodës apo Leposaviqit.

¹ Komunikata për shtyp nga Shërbimi evropian për veprim të jashtëm (European external Action Service) më 20 tetor 2011.

23. Paneli nuk është në dijeni se, nëse ka ndonjë, sa prej atyre përafërsisht 10 familjeve që kanë mbetur në kampin Osterodë janë parashtrues të kësaj ankesë.

Procedura kundër KB-së

24. Më 10 shkurt 2006 këshilli ka parashtruar një ankesë pranë KB-së lidhur me Ankesat të Palës së Tretë për personat e lënduar apo të vdekur.
25. Më 3 mars 2006 këshilli ka parashtruar një ankesë pranë Zyrës së Shërbimeve për mbikëqyrje të brendshme të UNHCR.
26. Më 4 korrik 2008 këshilli ka parashtruar një ankesë në lidhje me kushtet e jetesës dhe problemet shëndetësore në pesë kampet e administruara nga UNMIK-u të përmendura më lartë pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut.
27. Më 5 qershor 2009 Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) ka shpallur këtë ankesë si pjesërisht të pranueshme. Më 11 gusht 2009 Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i KB-së kishte kundërshtuar pranueshmërinë e asaj lënde, duke u bazuar se nuk ishin shterur rrugët ligjore në dispozicion.
28. Më 17 tetor 2009 PSSP ka lëshuar një Udhëzim Administrativ nr. 2009/1 duke zbatuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 rreth themelimit të PKDNj-së. Pjesët e saj 2.1, 2.2 dhe 2.3 parashikojnë se çdo ankesë e re apo që është ende në pritje pranë PKDNj-së, dhe e cila është apo që në të ardhmen mund t'i nënshtronhet Procesit apo Procedurave për Ankesa të Palës së Tretë të KB duhet të shpallet e papranueshme. Nëse një ankesë e tillë tashmë ishte shpallur e pranueshme, çështja duhej të rivlerësohej dhe të vendosej rishtas për të.
29. Për më tepër, Udhëzimi Administrativi ka kufizuar fushëveprimin e përkohshëm të kompetencave të PKDNj-së duke vendosur se asnjë ankesë e parashtruar pranë PKDNj-së nuk do të shpallet e pranueshme nëse është parashtruar pas datës 31 mars 2010.
30. Lënda e parashtruesve të ankesës pranë Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB ka qenë e pazgjidhur që prej 10 shkurtit 2006 pa shënuar ndonjë përparim.
31. Në vendimin e datës 31 mars 2010, PKDNj-ja së pari ka shqyrtuar kundërshtimin e ri të pranueshmërisë që ishte bërë nga ana e UNMIK-ut dhe që vinte nga Udhëzimi Administrativ nr. 2009/1. Së pari është vënë në dukje se seriozisht mund të vihet në pikëpyetje nëse PSSP-ja ka pasur kompetencë për të ndryshuar disa prej parimeve kryesore që përfshihen në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 duke "zbatuar" udhëzimin administrativ. Sidoqoftë, Paneli ka konstatuar se fakti qëndron se dispozitat e Udhëzimit kanë përbërë bazën ligjore të

funksionimit të PKDNJ. Është vërejtur se Udhëzimi Administrativ ka hequr kompetencat e PKDNj-së për të shqyrtuar nëse ankuesi para se ta parashtronte ankesën e tij pranë PKDNj-së kishte shterur të gjitha mjetet juridike. Për më tej, Paneli ka konstatuar se ankesat thelbësore të aplikantëve *prima facie* hyjnë brenda kompetencave të Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB dhe prandaj ishin dashur të shpalleshin të papranueshme.

32. Për më tej, PKDNj-ja ka konstatuar se pasi është kryer procesi i Ankesave të Palës së Tretë, ankuesit mund të kërkojnë nga PKDNj-ja të rihapin procedurat, pavarësisht prej afatit të fundit që ishte deri me datën 31 mars 2010, e cila ishte vendosur nga Udhëzimi Administrativ nr. 2009/1. Pastaj, PKDNj-ja do të vendos nëse do ta pranoj apo jo një kërkesë të tillë.
33. Më 25 korrik 2011, Zyra e Çështjeve Ligjore të KB-së nuk ka pranuar të veprojë tutje në procesin e ankesave të palës së tretë, duke deklaruar se ajo ankesë ka qenë kundër administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, sesa një ankesë për lëndim të personave romë. Panelit nuk i është dhënë ndonjë hollësi tjetër.

Procedurat pranë OECD (Organizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik)

34. Në qershor 2011, këshilli ka parashtruar një ankesë në emër të 129 romëve pranë Pika kontaktuese (The National Contact Point) të OECD në Norvegji. Ankesa supozonte se OJQ-ja norvegjeze, pra Kisha Norvegjeze për Ndihma (Norwegian Church Aid), e cila ka menaxhuar kampet e PZhBV nga viti 1999 deri në vitin 2009 për UNMIK-un dhe qeverinë e Kosovës, kishte shkelur udhëzimet e OECD, në mesin e të tjerave, edhe të drejtat e njeriut.
35. Në shtator 2011, ankesa ishte hedhur poshtë. Pika kontaktuese (The National Contact Point) ka konstatuar se Kisha Norvegjeze për Ndihma (Norwegian Church Aid) nuk mund të konsiderohej ndërmarrje sipas udhëzimeve të OECD.

Kontaktet me EULEX-in

36. Më 21 janar 2010, përmes një formulari në internet një përfaqësues i ankuesve kishte kërkuar takim me shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it për të diskutuar gjendjen në kampet e PZhBV në pjesën veriore të Kosovës.
37. Në të njëjtën ditë më 21 janar 2010, zyra për informim e EULEX-it ishte përgjigjur në emër të ShM të EULEX-it se nuk do të caktohej ndonjë takim i tillë dhe se ajo çështje nuk hynte në kuadër të mandatit të EULEX-it.
38. Më 2 shkurt 2010, përfaqësuesi i ankuesve kishte dërguar një memorandum prej 46 faqesh tek kryeprokurori i EULEX-it, duke kërkuar hetimin dhe ndjekjen penale për krime të rënda që ishin dhe po kryheshin ndaj banorëve romë në kampet e PZhBV.

39. Më 4 shkurt 2010, kryeprokurori i EULEX-it është takuar me përfaqësuesin e ankuesve dhe e ka njoftuar atë se nuk do të nis asnjë hetim lidhur me veprën e dyshuar penale, pasi ajo lëndë bie jashtë kompetencave të EULEX-it. Gjithashtu ai ka këshilluar se sa i përket asaj çështje ata duhet t'i u drejtohen institacione vendore.

LIGJI I ZBATUESHËM

VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rrëth misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË.

Neni 2 Deklarata e misionit

EULEX-i në KOSOVË do t'i ndihmojë institucionet, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në punën e tyre drejt stabilitetit dhe llogaridhëni si dhe në zhvillimet e mëtutjeshme dhe forcimin e sistemit të pavarur shumëtarik të drejtësisë, dhe të atij doganor, duke siguruar që këto institucionë nuk do të ndikohen politikisht dhe do t'i përbahen standardeve të pranuara ndërkombëtare dhe standardeve më të mira evropiane.

Neni 3 Detyrat

Me qëllim të realizimit të Deklaratës së Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur ose duke i mbështetur autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik, dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar për lëndën apo që punon në ekipin e përzier siç përcaktohet në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përfjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it çdoherë kur konsiderohen e nevojshme do të ketë kompetencë që të siguroj administrimin e duhur të drejtësisë, të caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përgjedhjen dhe me caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja.

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPPK)

Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës

12.1 Në çdo fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'i caktojë: a) një tjetër prokurori publik të Kosovës i cili punon në të njëjtën zyrë të prokurorisë, b) apo ndonjë prokurori të EULEX-it i cili do të merr përsipër hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2 Nëse kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e kryeprokurorit të EULEX-it, kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftojë kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët i cili duhet të përfillet nga kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3 Në rrethana urgjente, ose kur vonesa mund të ndikojë në kryerjen apo rezultatin e hetimit, në ndjekjen penale apo zhvillimin e drejtë të procedurave, kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmerr çdo veprim urgjent procedural, apo të caktojë cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

III. ANKESAT

40. Ankuesit pretendojnë se EULEX-i si organ qeverisës dhe administrator përgjegjës i kampeve të PZhBV që nga viti 2008 ka pasur njohuri rreth kushteve të rrezikshme të jetës, mirëpo nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t'i larguar romët nga ai kamp apo për t'u përkujdesur për ta.
41. Për më tepër, ata pretendojnë se duhet të zhvillohet ndonjë hetim nga EULEX-i rreth veprës së mundshme penale të kryer ndaj banorëve të kampit. Ata konstatojnë se iu ishte mohuar qasja në drejtësi dhe iu ishte refuzuar zgjidhja juridike apo tjetër, që do të ishte në gjendje të merrej me trajtimin e thelbit të ankesave të tyre që ngriter këtu lidhur me kushtet e këqija të jetesës dhe dëmtimit të supozuar të shëndetit dhe mirëqenies së tyre. Aplikantët bazohen në nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa).
42. Ankuesitë gjithashtu pretendojnë se kanë qenë viktima të shkeljes së nenit 2 (e drejta për jetë), nenit 3 (ndlalimi i torturës), dhe nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të vetëm Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore apo së bashku me nenin 13 (e drejta për zgjidhje juridike) dhe nenin 14 (ndlalimi i diskriminimit) të Konventës. Për më tepër, ata pretendojnë se ka pasur shkelje të këtyre neneve:
 - Nenet 1, 2, 3, 5, 7, 8, 10, 12, 17, 22, 25, 28 të Deklaratës së Përgjithshme të të drejtave të njeriut;

- Nenet 2 dhe 26 të Konventës Ndërkontaktuale lidhur me të drejtat civile dhe politike;
- Nenet 2, 10, 11, 12 të Konventës Ndërkontaktuale lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe politike
- Nenet 1, 2, 3, 5, 12, 16. të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave;
- Nenet 2, 3, 5, 6, 19, 23, 24, 27, 37 e Konventës së të drejtave të fëmijëve.

IV. LIGJI

E përgjithshme

43. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
44. Për aq kohë sa kjo lëndë ka të bëjë me kushtet e jetesës në kamp dhe rrezikimin e shëndetit dhe mirëqenies së ankuesve që ato bartin, në vërejtjet e veta EULEX-i pohon se nuk ka qenë përgjegjës për administrimin e kampit të PZhBV, gjithashtu se EULEX-i nuk duhet të mbahet përgjegjës për ndonjë gabim lidhur me këtë.
45. Për aq sa kjo ankesë ka të bëjë me parashtimet e ankuesve rreth mungesës së qasjes në drejtësi dhe mungesës së mjeteve juridike sa i përket akuzave për shkelje të të drejtave të njeriut, EULEX-i ka deklaruar se prokurorët e tij nuk kanë pasur obligim për të hetuar veprat e dyshuara penale të kryera ndaj banorëve romë të kampit. Ata nënvizuan se ankuesit kishin pretenduar se vepra penale e "shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm" (neni 365 i Gjykatës Penale të Kosovës), ishte kryer ndaj tyre. Ajo vepër nuk ishte e përfshirë në nenin 3.3. të Ligjit nr. 03/L-053 mbi juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (ligji mbi juridiksion) që kishte renditur veprat penale që e nxitin marrjen e kompetencave nga prokurorët e EULEX-it. Më tutje, EULEX-i ka vënë re se nën nenin 12 të Ligjit mbi Juridiksionin, prokurorët e EULEX-it kishin autoritet të merrnin përsipër hetimin apo ndjekjen penale të ndonjë vepre penale, në rast se prokurorët e Kosovës nuk janë të gatshëm apo janë të paaftë që të kryejnë detyrat e tyre dhe se kjo mosgatishmëri apo paaftësi për t'i kryer detyrat e tyre mund të rrezikoj hetimin apo ndjekjen penale përkatëse. Megjithatë, për të lindur mundësia e tillë, së pari lënda duhet t'i drejtohet një prokurori publik vendor. Nëse pasi që prokurori vendor ka qenë jo i gatshëm apo i paaftë për t'u marrë me lëndën, ankuesit mund ta njoftojnë kryeprokurorin e EULEX-it, i cili pastaj do të vendos nëse do t'i caktoj lëndën ndonjë prokurori tjetër publik, apo ndonjë prokurori të EULEX-it. EULEX-i ka nënvizuar se ankuesit nuk i kishin paraqitur ankesat e tyre pranë autoriteteve vendore të ndjekjes.

46. Në përgjigje, ankuesit kanë pohuar që pretendimi i EULEX-it se hetimi dhe ndjekja penale e krimeve ndaj banorëve romë të kampit nuk kishte hyrë brenda mandatit ka qenë e pabazuar. Sipas ankuesve, duke u bazuar në mandatin ekzekutiv, EULEX-i ka pasur detyrë që t'i mbrojë dhe përfillë të drejtat e njeriut në Kosovë, dhe posaçërisht të ndërhyjë atëherë kur veprimet e kontestuara ishin nxitur nga racizmi dhe atëherë kur autoritetet vendore të ndjekjes nuk kishin hetuar çështjen.
47. Ata ishin të mendimit se refuzimi i EULEX-it për të hetuar lëndën sipas Konventës kishte shkelur të drejtat e romëve. Ata veçanërisht iu drejtohen neneve 6 dhe 13 të Konventës.
48. Paneli mund të shqyrtoj vetëm shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, polici dhe dogana, ashtu siç saktësohet në rregullën 25, paragrin 1 të rregullores së vetë të punës.
49. Paneli konstaton se ankuesit në thelb ankohen që Paneli të konstatoj se ka shkelje të të drejtave të tyre lidhur me atë se EULEX-i nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për t'i zhvendosur romët e mbetur nga kampet e ndotura dhe për t'i ofruar atyre kujdes të duhur shëndetësor, dhe më përgjithësisht lidhur me atë se EULEX-i nuk ka ofruar ndonjë zgjidhje juridike sa i përket gjendjes për të cilën ka pasur ankesë.
50. Në lidhje me këtë, Paneli konstaton se EULEX-i asnjëherë nuk ka qenë përgjegjës për ndonjë kamp të PZhBV në Kosovë. Siç deklarohet më lartë në paragrin 17, sipas kompetencës së tij në vitin 2008 UNMIK-u ia kishte kaluar përgjegjësinë për kampet e tjera autoriteteve të Kosovës.
51. Në thelb, EULEX-i është mision për sundimin e ligjit. Deklarata e misionit të tij parashikon se "ai do t'i ndihmojë institucioneve të Kosovës, autoriteteve gjyqësore dhe agjencive për zbatimin e ligjit gjatë punës së tyre drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë dhe më tej drejt zhvillimit dhe përforcimit të një sistemi të pavarur shumë etnik gjyqësor dhe një policie shumë etnike dhe shërbimi doganor, duke siguruar se këto institucione nuk kanë ndonjë ndërhyrje nga politika dhe duke ndjekur standarde e pranuara ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane" (shih Veprimin e përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rrëth Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, neni 2). Kështu, atij i ka mbetur një mbetje e mandatit ekzekutiv paraqitur si në vijim: "[EULEX-i në Kosovë do të] merr përgjegjësitë e tjera, në mënyrë të pavarur apo në mbështetje prej autoriteteve të Kosovës për të siguruar ruajtjen dhe përkrahjen e zbatimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë" (shih Veprimin e përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rrëth Bashkimit Evropian për misionin e sundimit të ligjit në Kosovë, neni 3, pika h)). Mandati i përgjithshëm ekzekutiv i EULEX-it nuk përfshinë veprimtaritë rrëth ndonjë karakteri administrativ sa i përket çështjeve të strehimit, sigurimit të kujdesit shëndetësor, luftimit të ndotjes,

mbrojtjes së mjedisit apo çështjeve të politikave shoqërore. Si pasojë, administrimi apo përgjegjësia për administrimin e kampeve të PZhBV asnjëherë nuk ka qenë kompetencë apo përgjegjësi e tij.

52. Prandaj, çështjet e ngritura nga ankuesit lidhur me kushtet e përgjithshme të tashme që i kanë pasur në kamp siç janë: ndotja e mjedisit, dëmtimi i dyshuar i shëndetit të ankuesve, kujdesi i pamjaftueshëm shëndetësor, dhe mos zhvendosja e banorëve të kampit, nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.
53. Prandaj, këto çështje nuk hynë në kuadër të mandatit të Panelit, ashtu siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.
54. Për më tepër, Paneli nuk mund të mos e theksoj se shumica e veprimeve sa i përket zhvendosjes që kanë pasur për qëllim përmirësimin e gjendjes së personave që jetojnë në kampe, e që kanë ndodhur gjatë vieve të fundit janë bashkë financuar nga Bashkimi Evropian, USAID-i, zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ministria për komunitete dhe kthim dhe komuna e Mitrovicës.
55. Në analizën përfundimtare, Paneli konstaton se autoritetet e Kosovës, janë përgjegjës për marrjen e masave përkatëse në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje lidhur me gjendjen për të cilën ka pasur ankesë si në vijim: mbylljen e kampeve, zhvendosjen e banorëve të tyre dhe ofrimin e kujdesit të duhur mjekësor për ta. Në këtë kontekst, Paneli i kushton rëndësi deklaratës publike të bërë nga zyra e kryeministrit në prill të vitit 2009 se ai do të merret me problemet e ndotjes nga plumbi në kampet e PZhBV. Paneli është i kënaqur që përgjegjësia për t'u qasur këtij problemi mbetet tek autoritetet e Kosovës. Paneli tashmë në mënyrë të përsëritur ka konstatuar se nuk ka kompetencë për të shqyrta e veprimet apo mos veprimet e autoriteteve të Kosovës (shih në mes të tjera, lëndën e PShDNj-së nr. 2011-06, *Milazim Blakqori*, §21).
56. Më tej, Paneli vlerëson se ankuesit konstatojnë se atyre iu është mohuar qasja në drejtësi dhe nuk iu është ofruar ndonjë zgjidhe juridike apo tjetër, që do të ishte në gjendje për t'u marrë me thelbin e ankesave të tyre. Ata iu drejtohen neneve 6 dhe 13 të Konventës, të cilat ofrojnë këtë:

Neni 6 E drejta për një proces të rregullt

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë qoftë për të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale ndaj tij (...).

Neni 13 E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilat i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi shtetëror,

pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

57. Paneli konsideron se, sipas dokumenteve të paraqitura nga palët, kjo pjesë e ankesës ngreh çështje serioze sa i përket faktit dhe ligjit sipas neneve 6 dhe 13 të Konventës, ku për të vendosur rreth tyre nevojitet që të shqyrtohen meritat. Prandaj, Paneli përfundon se kjo pjesë e ankesës nuk është e pabazuar. Nuk është gjetur ndonjë arsyе tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

PËR KËTO ARSY, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën për aq sa ajo lidhet me përgjegjësinë e supozuara të EULEX-it që fillon prej kushteve të përgjithshme të jetesës në kamp, ndotjes mjedisore, rrezikimit të dyshuar të shëndetit, rrezikimit të përgjithshëm të shëndetit që ankuesit e kishin pësuar, mungesës së kujdesit të duhur shëndetësor dhe mos zhvendosjes së banorëve të kampit;

konstaton se kjo pjesë e ankesës sipas nenit 29 (d) të rregullores së vetë të punës është qartas e pabazuar;

KËTË PJESË TË ANKESËS E SHPALL TË PAPRANUESHME;

Pa i paragjykuar meritat **SHPALL TË PRANUESHME** ankesat lidhur me shkeljet e dyshuara të nenit 6 dhe 13 të Konventës dhe fton palët që të parashtrojnë dokumente shtesë sa i përket meritave të kësaj pjese të ankesës.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese